

**From:** Eling Prishtine [eling.pr@gmail.com]

**Sent:** Saturday, May 11, 2019 12:33 PM

**To:** info ero

**Subject:** Komentet ne lidhje me raportin konsultativ per tarifen nxitese

Te nderuar/a,

E lexuam me vemendje raportin tuaj "Mekanizmi i mbeshtetjes per ceqet e BRE-ve (20 MW solare fotovoltaike)" dhe po i japim komentet tona ne lidhje me tarifen nxitese per caqe shtese te BRE-ve. Dhe pasi qe ne kemi punuar nje park te tille te energjise solare dhe saktesisht i dijmë koston e shpenzimeve per ndertimin e parkut, mendojme qe edhe pse keni dhene ne menyre goxha te detajuar koston e ndertimit te nje parku, prap mendojme qe tarifa nxitese qe ERO ka propozuar nuk eshte reale dhe eshte e ulte duke u bazuar ne keto argumente.

1. Renja e cmimit ne teknologjine e paneleve solate e perfshine diku prej 30-40% te koston se projektit dhe kjo teknologji ka rene ne cmim tek prodhuesit e ndryshem diku afersisht 20% ;

2. Inverteret sipas trendeve qe jane duke shkuar ka zbritje ne kete teknologji diku prej 5-7% tek prodhuesit e ndryshem;

3. Pjesa percjellese tjeter sic jane: mbajtesit e paneleve, le qe nuk kane zbritje mirepo momentalisht kane ngritje ne cmim sepse cmimi i metaleve ka ngritje ne berze dhe ajo eshte thuaja e pa ndryshuar;

4. Trafostacionet te cilat jane pjese integruese e parkut poashtu llogariten ne berze e cila momentalisht eshte e pafavorshme;

5. Kabllote pjeset percjellese( nqrriqim, rrethoja etj) te cilat nevojiten per ndertimin e parkut prap nuk kane zbritje dhe nuk jane ne trend te renjes ne cmim;

6. Kostoja e tokes ndertimore ku behet ndertimi i parqeve te tilla, nuk eshte ne trend te renjes se cmimit; dhe

7. Varesisht prej pozicionit ku ndertohet parku, kycja ne rrjetin elektrik eshte nje problem qe terheqe me vete kosto te madhe.

Bazuar ne keto te dhena, ne uljen e koston te ndertimit te parqeve solare duhet llogaritur vetem renja e cmimeve te paneleve solare.

Andaj, konsiderojme qe duke u bazuar ne pervojen qe kemi ndertuar nje park te tille, shpenzimet kapitale, operative, faktori i ngarkeses (te cilin e keni llogaritur 1370 ore ne vit, per te cilin mendojme qe nuk eshte i sakte) dhe shpenzimet e tjera, mendojme qe tarifa nxitese e propozuar ne raport eshte e ulte.

Shpresojme qe komentet tona do ndihmojne ne rishqyrtimin e tarifave nxitese.

Ju faleminderit per mirkuptim,

Singerisht,

-

**NTSH "Eling"**

**Prishtinë**

**Mob: +383(0)44 433 467**

**+383(0)44 777 517**

**+383(0)49 843 959**

**Tel-Fax: +381(0)38 545 016**